

## Syllabusi i lëndës: Struktura dhe organizimi shoqëror

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Filozofik/Departamenti i Antropologjisë
Titulli i lëndës:	Struktura dhe organizimi shoqëror
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I, semestri II
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Caktohet
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Tahir Latifi
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:tahir.latifi@uni-pr.edu">tahir.latifi@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Fokusi i kësaj lëndë është që t'u ofrojë studentëve njohuri rreth strukturës dhe organizimit social të shoqërive njerëzore. Studimi i institucioneve reprezentative të grupeve shoqërore si familja, farefisi, lagjja ( <i>mahalla, barku, vllaznia</i> ), fshati dhe krahina, do të jetë bazë për njohje të strukturës dhe organizimit social. Një karakteristikë e shoqërisë është hierarkia sociale, si një strukturë jo vetëm simbolike, por një relacion pushteti – që nga grupet më të vogla, fiset, grupet/shoqëritë segmentare, e deri te shteti. Gjithashtu, do të shihet se si këto institucione, ndër të tjera, kanë rolin e socializimit, kontrollit social dhe solidaritetit të grupit.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Kjo lëndë ka për qëllim që studentëve t'u ofrojë njohuri rreth asaj se si shoqëritë njerëzore lidhen mes veti, struktura dhe organizimi social e politik i tyre. Kjo lëndë është e strukturuar në atë mënyrë që, në mënyrë kronologjike dhe përmes metodave krahasimtare, në rrafsh kohor dhe hapësinor, të tregojë se si shoqëritë njerëzore kanë funksionuar dhe si janë organizuar. Gjithashtu, një nga qëllimet e këtij kursi është studimi dhe njohja e formave të para të lidhjes mes njerëzve, pushteti dhe organizimi social dhe krijimi i klasave dhe shtresave shoqërore.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	– Në këtë lëndë, është menduar se studentët do të jenë në gjendje të marrin njohuri bazike për format, strukturat dhe organizimet shoqërore

	<p>të shoqërive njerëzore, në të gjitha periudhat kohore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Do të kuptojnë se cilët janë karakteristikat kryesore që e bëjnë të dallohet një grup shoqëror nga tjetri, ose, ngjashmëritë që ndajnë mes vete.</li> <li>– Do të kuptojnë për rëndësinë e lidhjes së grupeve shoqërore, me bazë fisi, fshati apo regjioni me shtetin.</li> </ul>
--	--

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>
Ligjërata	25
Punë praktike	20
Ushtrime	20
Konsultime	10
Punë në shtëpi	10
Punime seminarike	10
Studime individuale	10
Puna në bibliotekë	25
Përgatitja e testeve	10
Ushtrime për provime	10
<b>Totali i orëve</b>	<b>150</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Do këtë këtë ligjërime interaktiv, duke i bërë studentët aktiv gjatë ligjërimeve. Në varësi të mundësive që ka Universiteti i Prishtinës, do të organizohet edhe punë hulumtuese në terren, për të kuptuar praktikisht strukturën dhe organizimin social në Kosovë. Për më tepër, është paraparë që të këtë lexime përgatitore dhe hulumtime për tema përkatëse, të cilat më pas do të prezantohen, diskutohen dhe analizohen në ligjërime.
-------------------------------------	---

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi do të bëhet në bazë të suksesit të arritur gjatë gjithë semestrit. Studentët do të mbledhin pikët, në bazë të suksesit së treguar në testet gjatë semestrit, punimeve seminarike (ose ese), pjesëmarrjes aktive në ligjërime dhe ushtrime, përgatitjes paraprake – leximi (detyrë shtëpie) apo hulumtim studimor.
------------------------------	---

	<b>Nota</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Pikët</b>
--	-------------	-------------------	--------------

		10	(A)	Shkëlqyeshëm	91-100
Ese %	20	9	(B)	Shumë mire	81-90
Detyra dhe aktivitete në ligjërata	10	8	(C)	Mirë	71-80
Testi gjysemsemestral %	35	7	(D)	Kënaqshëm	61-70
Testi final %	35	6	(E)	Mjafton	51-60
<b>Total</b>	<b>100</b>	<b>5</b>	<b>(F,FX)</b>	<b>Mospërmbushje kriteri minimal</b>	<b>nën 51</b>

## Literatura

### Literatura bazë:

- Ulqini, Kahreman 1991: *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror. Fundi i shek. XVII deri me 1912*, Tirane, Akademia e Shkencave e RPS e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore.
- Ulqini, Kahreman 2003: *Struktura e shoqërisë tradicionale shqiptare*, Shkodër, Idromeno.
- Durham, Mary E. 2013: *Shqipëria e Epërme. Një udhëtim në Shqipërinë e Veriut të vitit 1908*. Përkthim: autori Piro Misha, Tiranë, IDK.
- Giddens, Anthony 2005. *Sociologjia*, Botoi, Fondacioni SOROS.
- Clastres, Pierre 2014: *Shoqëria kundër shtetit. Kërkime në antropologji politike*, Tiranë, Pika pa sipërfaqe. Përkthyer nga Orgest Azizi.
- Fortes, Meyer, and Evans-Pritchard, E. E. 1940: Introduction. In *African Political Systems*. London: Oxford University Press.
- Lévi-Strauss, Claude 1969: *The elementary structure of kinship*, Boston, Beacon Press.
- Berit Backer, *Behind the stone walls. Changing household organization among the Albanians in Yugoslavia*, Pejë, Dukagjini, 2003
- Janet Reineck, *The past as refuge. Gender, migration, and ideology among the Kosova Albanians*, University of California, Berkeley, 1991.
- Berishaj, Anton Kolë 2014: *Shoqëria pa shtet. Studim socioantropologjik*, Prishtinë,

	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Barth, Fredrik 1959: Segmentary opposition and the theory of games. Journal of the Royal Anthropological Institute 89: 5-22.</li> <li>– Durkheim, Emile 1964: The division of labor in society. New York: Free Press.</li> <li>– Evans-Pritchard, E. E. 1940: <i>The Nuer. A description of the modes of livelihood and political institutions of a Nilotic people</i>, Oxford, Clarendon Press.</li> <li>– Fortes, Meyer 1963: <i>Social structure. Studies presented to A. R. Radcliffe-Brown</i>, New York, Russell &amp; Russell INC.</li> </ul>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Temat</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje: njohje me lëndën
<i>Java e dytë:</i>	Organizimi i jetës në periudha të hershme të njerëzimit
<i>Java e tretë:</i>	Organizimi social në shoqëritë para-shtetërore
<i>Java e katërt:</i>	Fiset dhe klanet
<i>Java e pestë:</i>	Shoqëria segmentare
<i>Java e gjashtë:</i>	Organizimi shoqëror dhe lidhjet farefisnore
<i>Java e shtatë:</i>	Shoqëritë segmentare dhe shteti
<i>Java e tetë:</i>	Testi 1
<i>Java e nëntë:</i>	Martesa dhe krijimi i aleancave
<i>Java e dhjetë:</i>	Struktura dhe organizimi shoqëror i shqiptarëve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Fisi dhe fshati
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Struktura organizative dhe përfaqësuese
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Bajraku
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Organizimi social, politik dhe shteti
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Dorëzimi i eseve